



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 51.
Prishtinë, më 02.10.2012 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB, Elita Vokshi, Lejla Selimi, Shpend Qamili, përfaqësuese të zyrës së EULEX Visar Bivolaku, përfaqësuese të zyrës së KDI-së Nevahir Hajzeri, përfaqësuese të zyrës së IND-së Visar Bikliqi, përfaqësues të KKK Vetton Berisha, përfaqësues të zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Raportit të gjendjes shëndetësore të komuniteteit Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Mitrovicë, në zonën e kontaminuar me plumb

I ftuar:

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë z. Ferid Agani

Kryesuesi - konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime

Kryesuesi – në fjalinë e tij tha se në mbledhjen paraprake, Komisioni ka marrë qëndrim të kërkohej raporti i MSH dhe njëherit të jetë prezent Ministri i Shëndetësisë me arsye të raportojë për gjendjen shëndetësore të Komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptian të Mitrovicës, në zonën e kontaminuar me plumb.

Në bazë të kërkesës tonë, Komisioni ka marrë raportin me shkrim nga MSH, ndërsa gjatë këtij takimi pa arsye mungon pjesëmarrja e ministrit apo të ndonjë këshilltari të ministrisë.

Në mos prezencën e ministrit, Komisioni do të shqyrtojë raportin e MSH lidhur me gjendjen shëndetësore të Komuniteteve Romë, Ashkalinj dhe Egjiptian, ku për procedim të mëtejshëm do të merren vendim konkret për gjetjen e zgjedhjes së komunitetit në fjalë, në parandalimin e helmimit me plumb, në zonën e Mitrovicës,

Ai hapi debat, lidhur me marrjen e opinioneve nga anëtarët e komisionit.

Albert Kinolli – me theks të veçantë tha se mos prezenca e ministrit apo të përfaqësuesve zyrtar të ministrisë përkatëse paraqet neglizhencë, të cilat janë të lidhura me problemet e këtyre komuniteteve.

Në mënyrë zyrtare kemi kërkuar raport me shkrim nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me gjendjen shëndetësore të komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian, të cilët jetojnë në zonën e kontaminuar me plumb, dhe se i njëjti është marrë me vonesë.

Theksoi se Komisioni ka kryer punën e vet dhe se nuk e është e arsyeshme të shqyrtohet raporti në mungesë të ministrit, ku si prioritet ishin të obliguar të përgjigjen ftesës, për të dhënë sqarime lidhur me pyetjet tona konkrete

Ai tha se në raport shkruan, me 5 maj 2011 është bërë një prezantimi i projektit për vaksinimin plotësuese të grupeve, por nuk është bërë përshkrimi në cilën pjesë është bërë prezantimi i projektit, ndërsa shtoi se këta njerëz kanë më shumë nevojë për veprim se sa për prezantim të projekteve.

Kërkesa e tij ishte që ti drejtohem MSH, dhe se gjatë vizitës në terren të jenë prezent ndonjë mjekë apo ekspertë, ku më pas do të bëhen krahasime në mes raportit të MSH dhe gjendjes aktuale të qytetarëve të cilët jetojnë në kampin e zonës së Mitrovicës

Xhevdet Neziraj – Shprehu qëndrimin e tij se ky raport duhet të shqyrtohet vetëm në prezencë të ministrit të Shëndetësisë, dhe është i mendimit se ky raport është marrë nga ndonjë OJQ sepse nuk ka formë të standardizuar të Ministrisë.

Ky raport paraqet diskriminim të të drejtave të komuniteteve nga se nuk është e drejtë Institucionale të përdoren shprehjet e akronimit RAE. Sipas tij duhet të përdoret shprehja e tri komuniteteve ashtu siç janë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin për promovimin e të drejtave të komuniteteve.

Gjithashtu konsideron se është e papranueshme shprehja ‘mahalla e Romëve’ paraqitet imazh të vrazhdë për Kosovën, nga se jemi në periudhën ku duhet të plotësohen standardet për të hyrë në Evropë.

Myfera Sinik – u pajtua që të mos shqyrtohet raporti i MSH, pa prezencën e vetë ministrit.

Propozimi i saj ishte se në takimin e radhës përveç ministrit të MSH të ftohet edhe Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga se ka të bëjë edhe me çështjen e ndotjes së ambientit.

Glauc Konjufca – tha se është një periudhë e gjatë ku ministrat nuk i përgjigjen ftesës së komisioneve parlamentare. Ministrat duhet të respektojnë kushtetutshmërinë, që i obligon kur thirren në përgjigjësi nga komisionet parlamentare.

Sa i përket raportit të MSH, nuk akordohet të shqyrtohet raporti pa prezencën e ministrit të MSH i cili ka obligim të ofrojë sqarime lidhur me problemet shëndetësore me të cilat ballafaqohet komuniteti Romë Ashkali dhe Egjiptian, të cilët jetojnë në territorin e kontaminuar me plumb, në zonën e Mitrovicës.

Ai u përqendrua në dy pyetje të cilat ndërlidhen me raportin, çështja e vaksinimit dhe si çështje e dytë zhvendosja e pjesëtarëve të cilët jetojnë në këtë zonë. Mendimi i tij ishte që këtyre pjesëtarëve t'ju sigurohet një vend i përshtatshëm për jetesë, nga se e gjithë kjo situatë paraqet shkelje të të drejtave të komuniteteve, siç thuhet edhe në raportin e Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetësisë.

Jemi deputet të profesioneve të ndryshme dhe se për ne nuk janë të kuptueshme shprehja e terapisë me sukcimer (relator), andaj kërkoi që MSH të ofrojë sqarime në rastet konkrete.

Ai tha se ofrimi i shërbimeve shëndetësore që i ofrohen këtyre komuniteteve nuk mund të jenë në kompetenca të organizatave joqeveritare, ata mund të ofrojnë vetëm mendime dhe sugjerime, ndërsa përgjegjësia i takon Institucioneve tona publike shëndetësore.

Pajtohet që në takimin e radhës të jenë prezent ministri i MSH dhe ministri i resurseve përkatëse. Kjo çështje është urgjente dhe propozoi që të diskutohet lidhur me temat që ndërlidhen me ambientin, çështjen e zhvendosjes dhe kontaminimin me plumb, në zonën e Mitrovicës.

Kryesuesi – pajtohet me parafolësit, ftesa të mbetet e hapur dhe se në mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MSH, me arsye të raportojë për gjendjen shëndetësore të Komunitetit në fjalë dhe të ftohet edhe ministri i MMPH.

Më pas grupi punues do të vizitojë zonën e Mitrovicës, ku në bazë të vlerësimeve të përgjithshme Komisioni do të dal me rekomandime konkrete në Kuvend.

Elmi Reçica – shprehu qëndrimin e tij, që komisioni të deklarohet se temat e tilla në të ardhmen të mos shqyrtohen pa prezencën e ministrit apo të ndonjë përfaqësuesi të Ministrisë së Shëndetësisë. Mendimi i tij ishte kjo pikë të shtyhet për mbledhjen ardhshme, me propozim që të përsëritet ftesa e ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe njëherit pajtohet të ftohet ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mënyrë që një herë e përgjithmonë të zgjidhet çështja e qytetarëve të cilët jetojnë në zonën e Mitrovicës.

Pas diskutimeve dhe sugjerimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Në mbledhjen e radhës, më datën 10.10.2012, në ora 11,00, të përsëritet ftesa e Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me prezantimin e raportit me shkrim, për gjendjen shëndetësore të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Mitrovicë, zonë e kontaminuar me plumb. Gjithashtu, të ftohet Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me situatën aktuale të ambientit, në zonën e kontaminuar me plumb të Mitrovicës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic